



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 187/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 30.04.2021 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Isometric” SHPK, në procedurën e prokurimit “*Kërkesë për propozim – Marrëveshje kuadër*”, me objekt “*Blerje maja pipetash për nevoja të QSUNT*”, me nr. REF-87646-02-19-2021, me fond limit 818,000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 04.03.2021, nga autoriteti kontraktor Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.

Ankimues: Operatori ekonomik “Isometric” SHPK
Adresa: Rr. “Vaso Pasha”, Nr.3, banesa 1, Tiranë.

Autoriteti kontraktor: Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”
Adresa: “Rruga e Dibrës”, Nr. 372, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, Vendim i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe më pas ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektet e ankesës të ankimuesit.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 22.02.2021 është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit *Kërkesë për propozim – Marrëveshje kuadër*”, me objekt “*Blerje maja pipetash për nevoja të QSUNT*”, me nr. REF-87646-02-19-2021, me fond limit 818,000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 04.03.2021, nga autoriteti kontraktor Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.

II.2. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, rezulton se autoriteti kontraktor në datë 09.03.2021, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- | | |
|---------------------|-----------------------------|
| 1. “Isometric” SHPK | 573,000 lekë, Skualifikuar; |
| 2. “Fedos” SHPK | 678,000 lekë, Kualifikuar; |
| 3. “Krijon” SHPK | 726,000 lekë, Kualifikuar; |

II.3. Në datën 09.03.2021, operatori ekonomik “Isometric” SHPK, është njoftuar elektronikisht për skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi, me arsyetimin si më poshtë:

“OE nuk ka paraqitur vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka.

Nuk ka paraqitur dëshmi nga operatori ekonomik për furnizime të mëparshme të ngjashme sipas kërkesave të pikës 2.3 Kapaciteti teknik. OE ka paraqitur fatura të cilat nuk janë sipas DST.”

II.4. Në datën 09.03.2021, operatori ekonomik “Isometric” SHPK, ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke argumentuar si më poshtë vijon:

“[...]Konfirmojmë në mënyrë absolute se të dy arsyetimet nuk qëndrojnë pasi:

1) Lidhur me pjesën se: Nuk ka paraqitur dëshmi nga operatori ekonomik për furnizimë të mëparshme të ngjashme sipas kërkesave të pikës 2.3 Kapaciteti teknik. Oe ka paraqitur fatura për mallra të cilat nuk janë sipas kërkesave të DST.(mallra të ngjashme)

Ne stafin tonë ka Inxhinierë Bioteknolog Molekular të cilët kanë punuar ndër vite me pajisjet RT-PCR, PCR apo ekstraktorë molekularë për të cilat majat e pipetave apo mikropipetimi janë proces rutinore dhe gjithashtu theksojmë me kompetencë siç edhe ju e keni aprovuar nga kërkesat tuaja se majat janë: Maja pipetash për realizimin e analizeës RTPCR për detektimin e SARS COV-2 (përdoren për përpunimin e mostrës)

Ju ftojme që të riverifikoni në sistem elektronik faturat e ngarkuara specifikisht :

Folderin me emërtimin : Fatura të ngjashme (1,34 MB) e ngarkuar në 3.3.2021 ora 16:10 faqa e 2

Në faturen tatimore të shitjes me nr serie 83336224 me dateë 01/08/2020 specifikisht :

Art 1. PCR tubes 0.2 mi5080 copë me vlerë 3,657.60 Euro

Art 12. PCR primers 58 copë me vlerë 5,162 Euro (bashkëngjitur kopje e faturës e cila është e ngarkuar në sistem)

Konfirmojmë se artikujt e mësipërm jo vetëm që janë të ngjashëm por janë tërësisht identik për aplikueshmërinë në PCR e kërkuar dhe vlen të theksohet se janë materiale të së njëjtës natyrë që janë shitur në Itali po për të njëjtin qëllim gjatë periudhës së pandemisë.

2) Lidhur me pretendimin se: OE nuk ka paraqitur vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të energjisë elektrike.

Do iu luteshim të rishikoni sistemin elektronik edhe një herë pasi dokumenti është i ngarkuar me emërtimin e folderit:

Signed Isometric (1) pdf (1,1MB) 2.3.2021 ora 15:43 (bashkëngjitur Vërtetimi i Detyrimeve të OSHEE i ngarkuar në sistem) [...]

II.5. Referuar dokumentacionit bashkëlidhur ankesës së operatorit ekonomik ankimues si dhe informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, ky i fundit më anë të shkresës nr. 869/5 prot, datë 26.03.2021, i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik “Isometric” SHPK, duke e pranuar pjesërisht atë, me arsyetimin si më poshtë:

“[...]Për sa i përket pretendimit për depozitimin e Vërtetimit të OSHEE:

KSHA konstatoi se OE ka paraqitur në SPE Vërtetim nr. OSHEE-2021-2627315-WO, datë 22.02.2021, ku citohet se: Bazuar në deklaratimet e deklaruesit (përfaqësuesit ligjor) z. Nadiel Çadri, vërtetojmë se kërkuesi ISOMETRIC SHPK nga verifikimet e kryera në Sistemin e Faturimit, për kontraten me kod TRIB030050162443 titullar i së cilës është Selim Spahiu rezulton të ketë në total 0

lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri në datën 22.02.2021, përfshirë faturën koherente të muajit Janar 2021.

Në nenin 27, pika 5. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, “Kontratat e Mallrave” të VKM Nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar autoriteti kontraktor kërkon: c) një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastiit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik.

Në nenin 46, pika 1, gërma “b”, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit”.

Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Në Ekstraktin e QKB të Operatorit Ekonomik ofertues, adresa e ushtrimit të aktivitetit rezulton: TIRANE Rruga Vaso Pasha, Nr.3, B.1;

Ndërkohë që Vërtetimi i OSHEE i administruar citon se: për kontratën me kod TRIB030050162443, titullar i së cilës është Selim Spahiu;

Vërtetimi i administruar citon se titullar i kontratës TRIB030050162443, është z. Selim Spahiu, dhe jo Shoqëria Isometric SHPK, ndërkohë që neni 27/5/c kërkon shprehimisht që, çdo OE / BOE që oferton në një procedurë prokurimi, dhe që ushtron veprimtari dhe që është i regjistruar në territorin e Republikës së Shqipërisë, në mënyrë që të kualifikohet duhet që të paraqesë: c) një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Vërtetimi i paraqitur nga OE, vërteton se Z. Selim Spahiu nuk është debitor për energjinë e maturuar dhe jo OE Isometric SHPK, OE nuk ka paraqitur asnjë lloj dokumentacioni (Kontratë Qiraje, Huapërdorimi etj.,) lidhjen ligjore të OE Isometric SHPK, me Z. Selim Spahiu dhe të vërtetojë që Kontrata e Lidhur është kontrata që shfryzëtohet nga ky OE, për këtë arsye KSHA vlerëson se OE nuk e plotëson këtë kriter të kërkuar në DST.

Për këtë arsye kërkesa e OE për këtë pikë nuk qëndron.

II. Për sa i përket pretendimit për depozitimin e kontratave të ngjashme:

KSHA konstatoi se OE ka paraqitur në SPE faturat si më poshtë: - Faturë Tatimore me nr. 83336224, datë 01.08.2020

Në nenin 27, pika 4. “Kontratat e Mallrave” të VKM Nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar autoriteti kontraktor kërkon: Për të provuar përvojën e

mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit. Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në faturën e paraqitura, OE rezulton se ka shitje të mallrave të ngjashëm dhe e kalon vlerën e fondit limit për kontratën e shpallur nga AK. Për këtë arsye KSHA vlerëson se OE e përmbush kërkesën e DST për këtë pikë, për sa i përket furnizimit me mallra të ngjashëm. [...]"

II.6. Në datën 30.03.2021, operatori ekonomik "Isometric" SHPK ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke kundërshtuar vetëm arsyen e skualifikimit të lënë në fuqi nga komisioni i shqyrtimit të ankesave, me argumentimin si më poshtë vijon:

"[...]Përmbledhje: Më sipër gjendet ankimimi i kompanisë ISOMETRIC SHPK dhe kthimi i përgjigjes i QSUNT.

Në fillim AK kishte ngritur dy argumentime lidhur me refuzimin e kompanisë ISOMETRIC SHPK:

1) Mungesa e kontratave të ngjashme; 2) Mungesa në sistem e Vërtetimit të debisë

Pasi paraqitem ankimit dhe arsytimit se të dy dokumentet ishin të ngarkuara në sistem dhe kontratat e ngjashme vërtetimi i Oshee, Autoriteti atëherë pranoi kërkesën se kontratat ishin të ngjashme dhe se lidhur me vërtetimin e Debisë për OSHEE, tashmë AK konfirmom se qenka në sistem por nuk është e saktë.

Kërkojmë nga KPP, lidhur me të drejtën që i jep ligji të përcaktojë nëse Vërtetimi i Oshee është i saktë apo jo pasi mbas disa arsyeve për refuzim përfundimisht mbeti vetëm vërtetimi i OSHEE.

Vërtetimi i administruar citon se titullar i kontratës TRIB030050162443 është z. Selim Spahiu, dhe jo Shoqëria Isometric SHPK, ndërkohë që neni 27/5/c kërkon shprehimisht që, çdo OE / BOE që oferton në një procedurë prokurimi, dhe që ushtron veprimtari dhe që është i regjistruar në territorin e Republikës së Shqipërisë, në mënyrë që të kualifikohet duhet që të paraqesë: c) një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Vërtetimi i paraqitur nga OE, vërteton se Z. Selim Spahiu nuk është debitor për energjinë e maturuar dhe jo OE Isometric SHPK, OE nuk ka paraqitur asnjë lloj dokumentacioni (Kontratë Qiraje, Huapërdorimi etj.) lidhjen ligjore të OE Isometric SHPK, me Z. Selim Spahiu dhe të vërtetojë që Kontrata e Lidhur është kontrata që shfryzëtohet nga ky OE, për këtë arsye KSHA vlerëson se OE nuk e plotëson këtë kriter të kërkuar në DST

Theksojmë Ak kishte mundësi:

1) Autoriteti Kontraktor fillimisht posedon të drejtën për të këkuar informacion dhe për të verifikuar vlefshmërinë dhe vërtetësinë e dokumenteve të ngarkuara në sistem edhe pranë FSHU.

2) Autoriteti Kontraktor mund të kërkonte sqarim dhe kompania ISOMETRIC SHPK do të paraqiste çdo dokument të nevojshëm nga AK.

Gjithashtu duke e rikthyer nga dy arsyetimet e refuzimit 1) mungesa e kontratave të ngjashme 2) Mungesa në sistem e vërtetimit të OSHEE, pra AK pretendonte se kishte dokument fare të ngarkuar në sistem, automatikisht pretendojmë se interpretimi është tendencioz. Vërtetimi i Debisë është një

dokument ligjor i cili është konfirmuar nga një insitucion shtetëror të cilët mbajnë përgjegjësi ligjore për dokumentet që lëshojnë. Është e pamundur të kërkosh një vërtetim debie nëse kontrata nuk do të ishte në perdorim të kompanisë. ISOMETRIC shpk kur ka aplikuar për të marrë vërtetimin e debisë ka paraqitur kontratat e qirasë faturat dhe të gjitha dokumentet e kërkuar nga OSHEE. Për ISOMETRIC SHPK nuk do të ishte problem paraqitja e kontratës së OSHEE por kjo nuk është kërkuar në asnjë pikë dhe në asnjë moment nga AK. Apriori nëse kontrata nuk do të ishte në përdorim nga ISOMETRIC Shpk, OSHEE nuk do të lëshonte vërtetimin, gjithashtu vlen të theksohet se është lehtësisht e verifikueshme se adresa në QKB dhe se kontrata e OSHEE i takojnë të njëjtës adrese të konfirmuar nëpërmjet vërtetimit të Oshee.[...]”

II.7. Nëpërmjet shkresës nr. 869/7 prot., datë 09.04.2021, protokolluar me tonën në datën 13.04.2021, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Isometric” SHPK mbi skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me arsyen: “[...] OE nuk ka paraqitur vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka.[...]”. Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën nr. 8, pika 1, gërma “dh” “Kriteret e veçanta të kualifikimit” në dokumentet standarde të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

“Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri”

III.1.2. Në përmbushje të kriterit të mësipërm, operatori ekonomik ankimues “Isometric” SHPK ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), vërtetimin OSHEE-2021-2627315-WO, datë 22.02.2021, në të cilin vërtetohet si më poshtë:

“[...]Bazuar në deklaratimet e deklaruesit (përfaqësuesit ligjor) z. Nadiel Çadri, vërtetohet se kërkuesi ISOMETRIC SHPK nga verifikimet e kryera në Sistemin e Faturimit, për kontratën me kod TRIB030050162443, titullar i së ciles është Selim Spahiu, rezulton të ketë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri në datën 22.02.2021, përfshirë faturën koherente të muajit Janar 2021,

Vërtetimi lëshohet me kërkesën e ISOMETRIC SHPK, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave, Nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e Rregullave për Prokurimin Publik”, dhe jo më vonë se pesë ditë nga data e depozitimit të kësaj kërkesë [...]”

III.1.3. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.”*

III.1.4. Në pikën 5, gërma ”c” të nenit 27, të VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon: një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik.”*

III.1.5. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se operatori ekonomik ankimues “Isometric” SHPK ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike vërtetimin OSHEE-2021-2627315-WO, datë 22.02.2021, sipas formatit të miratuar, me anë të së cilës vërtetohet se subjekti “Isometric” SHPK nuk rezulton debitor për kontratën TR1B030050162443, përfshirë edhe muajin e fundit të maturuar referuar datës së zhvillimit të procedurës së prokurimit. KPP gjykon se Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike SHA është institucioni i ngarkuar me akt nënligjor për lëshimin e vërtetimit të debisë për personat fizikë dhe juridikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik, si dhe institucioni që menaxhon sistemin e të dhënave për pagimin e energjisë elektrike për të gjithë subjektet përdoruese të energjisë elektrike për të gjithë kontratat e lidhura midis OSHEE-së dhe subjekteve përdoruese të energjisë elektrike, e për këtë arsye përpara lëshimit të vërtetimit OSHEE ka kryer verifikimet përkatëse për të vërtetuar lidhjen e subjektit “Isometric” SHPK me kontratën TR1B030050162443, pavarësisht se titullar i kësaj të fundit rezulton një person tjetër.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik “Isometric” SHPK qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, Vendim i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Isometric” SHPK, për procedurën e prokurimit “Kërkesë për propozim – Marrëveshje kuadër”, me objekt “Blerje maja pipetash për nevoja të QSUNT”, me nr. REF-87646-02-19-2021, me fond limit 818,000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 04.03.2021, nga autoriteti kontraktor Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.
 2. Të anullojë vendimin e autoritetit kontraktor mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Isometric” SHPK dhe të korrigojë shkeljet duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.
 3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Isometric” SHPK
 5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Nr. 504 Protokoli Datë 30.03.2021

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaid Myzyri